



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PEQIN

Peqin 04.04.2019

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE
DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL NE KATEGORINE EKZEKUTIVE
(Specialist)**

**Lloji i diplomës “ Agronom i Larte ”
Niveli minimal i diplomes “Bachelor”**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, IV dhe VI të VKM nr Nr. 243, datë 18.3.2015, **Njësia e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Peqin** shpall procedurat e pranimit në shërbimin civil për pozicionin:

Specialist Bujqesie Kategoria IV-a

Pozicioni më sipër u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele ne sherbimin cilvil!

Vetëm në rast se, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

Për të gjitha procedurat (lëvizje paralele, pranimi ne sherbimin civil)
aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE:	15.04.2019
Afati për dorëzimin e dokumentave për PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL:	22.04.2019

I. QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT TË PUNËS;

Qëllimi i përgjithshëm i drejtorisë është hartimi dhe zbatimi i politikave, për përcaktimin e procedurave, rregullave e standarteve për mbështetjen e prodhimit bujqësor, sigurimin e cilësive së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, kushtet për prodhimin, tregëtimin, e produkteve bujqësore.

II. DETYRAT KRYESORE

Është nëpunës civil, ka varësi nga drejtori Financës dhe Buxhetit dhe ka për detyrë:

1. Përgjegjes për transferimin, testimin, përshtatjen dhe futjen e teknologjive të reja, sensibilizimin dhe mbështetjen e fermerëve për ruajtjen e burimeve dhe përdorimin e qendrueshëm të tyre;
2. Përgjegjës për transferimin e teknologjive bujqësore nëpërmjet eksperimentimit, monitorimit të testimit, në përshtatje me standartet e sigurisë ushqimore;
3. Përgjegjes për sigurimin e ekspertizës teknike në fushën e bujqësisë për strukturat e shërbimit këshillimor, shoqatat, fermerët dhe agrobiznesin;
4. Përgjegjës për ndërmarrjen e aktiviteteve me fermerët në formën e takimeve, fushatave, demonstrimeve, ditëve fushore, trajnimeve e panairëve;
5. Përgjegjës për dhënjen e asistencës tek fermerët për kriteret e përfitimit të subvencioneve, plotësimin e dokumentacionit për të siguruar mbështetje nga programe të ndryshme;
6. Ndihmon në krijimin dhe zhvillimin e shoqatave të fermerëve (prodhues, tregëtues, e përpunues).
7. Përgjegjës për organizimin e vrojtimit sinjalizimit të mbrojtjes së bimëve nga sëmundjet e dëmtuesit si dhe mbi masat profilaktike në grup të fermerëve;
8. Përgjegjës për dhënje asistencë fermerëve mbi përdorimin e pesticideve në bimët bujqësore
9. Ushtron kontrolle të vazhdueshme në tregjet e shitjes me pakicë të farërave dhe pesticideve bujqësore konform standarteve duke mos lejuar tregëtimin pa lishencë.
10. Përgjegjës për administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit të transferuar në pronësi të tyre sipas menyrës të përcaktuar në ligj.
11. Ndihmë e dhënje asistencë në zbatim të vendimeve e udhëzimeve fermerëve të cilët e kanë tokën në përdorim për ta kaluar në pronësi.
12. Kontrollon punën e përditshme të specialistëve në varësi për plotësimin e detyrave që janë ngarkuar.
13. Kryen studime dhe organizon sistemin e informacionit për sektorin e bujqësisë.
14. Zbaton detyra të tjera të caktuara nga drejtori.

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

- a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- ç) Të plotësojë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si më poshtë:

Arsimi:

Arsimi i lartë – Universiteti Bujqësor Diplomë në Agronomi i Lartë.

Përvoja :

- Te kete te paktën nje vit eksperience pune si nenpunes civil i se njejtës kategori

Tjetër:

- Të ketë aftësi të mira komunikuese, koordinuese dhe të punës në grup.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Peqin, dokumentat si më poshtë:

a-Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

b-Fotokopje të diplomës.Nese aplikanti disponon nje diplome te nje Universiteti te huaj,atehere ai duhet ta kete ate te njehsuar prane Ministrise pergjegjese per Arsimin.

c. Fotokopjen e listes se notave.Nese ka nje diplome dhe liste notash te ndryshme me vlersimin e njohur ne shtetin Shqiptare ,atehere aplikanti duhet ta kete ate sipas sistemit Shqiptar.

d-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

e-Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

f-Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

g-Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore / Vërtetim të gjendjes gjyqësore;

h-Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

i-Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.

j-Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

k.Fotokopje e aktit të emerimit si nëpunës civil për kategorinë për të cilën konkuron

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 15.04.2019

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **17.04.2019** Njësia e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Peqin do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit të Bashkisë, **listën e kandidatëve** që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, vendin, datën dhe orën e sakte.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Peqin nëpërmjet adresës së e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligjin nr. 139, dt.17.12.2015 “Për veteqeverisjen vendore”
- Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”
Ligjin Nr.9244, date 17.6.2004“Per mbrojtjen e tokes Bujqesore
Ligjin Nr. 7501, date 19.7.1991“Per Token” – *(I përditësuar)*

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.
 - ☒ Struktura e ndarjes së pikëve të vlerësimit të kandidatëve është, si më poshtë vijon:
 - ☒ a) 40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar, i ndarë: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv;
 - ☒ b) 60 pikë intervista me gojë.
- ☒ Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Peqin do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për shpalljen e fituesit.

2 PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende është vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Këtë Informacion do ta merrni portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e Bashkisë Peqin duke filluar nga data 22.04.2019.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NE SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë shërbimit civil të cilët plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr. 152/2013:

a-Te jete shtetas shqiptar

b-Te kete zotesi te plote per te vepruar

c-te zoteroj gjuhen shqipe ,te shkruar dhe te folur.

d-te jete ne kushte shendetesore qe e lejojne te kryeje detyren perkatese

e.te mos jete i denuar me vendim te formes se prere per kryerjen e nje krimi apo per kryerjen e nje kundarvajtje me dashje.

F.Ndaj tij te mos jete marre masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil,qe nuk eshte shuar sipas ligjit Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”,i ndryshuar.

Kandidatet duhet te plotesojne kriteret e vecanta si vijon.

- a) Të zotërojë diplomë Universiteti Bujqësor Diplomë në Agronomi i Lartë.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a-Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

b-Fotokopje të diplomës.

c-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d-Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

e-Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

f-Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

g-Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore / Vërtetim të gjendjes gjyqësore.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhet në Bashkinë Peqin ***Dokumentat per proceduren e pranimit ne kategorine ekzekutive dhe aplikimi duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 22.04.2019.***

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **29.04.2019** Njësia e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Peqin do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e ngritjes në detyrë, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Bashkia Peqin për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligjin nr. 139, dt.17.12.2015 “Për veteqeverisjen vendore”
- Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”
Ligjin Nr.9244, date 17.6.2004“Per mbrojtjen e tokes Bujqesore
Ligjin Nr. 7501, date 19.7.1991“Per Token” – (I përditësuar)

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim deri në 60 pikë.
- b- Për intervistën e strukturuar me gojë deri në 25 pikë.
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të

lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”
<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Peqin do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin cilil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e Bashkisë Peqin për fazat e mëtejshme të procedurës së konkurimit:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Bashkisë Peqin dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Specialiste e Burimeve Njerezore

/Edlira Elezi/

KRYETARI BASHKISE

/Saimir Hasalla